

**INTERVISTË E KRYETARIT TË PREZENCËS SË OSBE-SË NË SHQIPËRI,
AMBASADORI EUGEN WOLLFARTH, PËR GAZETËN “TELEGRAF”**

14 maj 2012

Zoti Ambasador, a keni besim se reforma zgjedhore do të garantojë zgjedhje të lira dhe të ndershme në Shqipëri, me synimin që të mos përsëriten sërish problemet e zgjedhjeve të kaluara?

Komisioni i posaçëm për reformën zgjedhore ka punuar me intensitet dhe me vullnetin më të mirë për të hartuar amendamente që do ta përmirësojnë ndjeshëm Kodin Zgjedhor, në mënyrë që historia e zgjedhjeve problematike t’i përkasë së shkuarës. Deri tani, janë përgatitur propozime shumë të mira. Unë jam i bindur se anëtarët e komisionit do të përgatisin një draft të mirë të konsoliduar përfundimtar, i cili do të shërbejë si platformë e qëndrueshme për zgjedhje të suksesshme parlamentare, vitin e ardhshëm. Megjithatë, Kodi Zgjedhor nuk duhet parë si faktori i vetëm që përcakton suksesin apo mosesuksesin e zgjedhjeve. Në këndvështrimin tim, vullneti politik i mjaftueshëm, për të cilin na duhet të flasim shpesh, do të luajë një rol kyç në zhvillimin dhe rezultatin e zgjedhjeve. Ky vullnet mund të çojë në sukses edhe kur ka mungesa ligjore, ashtu sikurse mund ta prishë procesin edhe në rast se korniza ligjore është thuajse e përsosur. Deri më tani, më duhet të them se shoh shumë vullnet të mirë në komision, shoh një frymë shumë të mirë në gjetjen e zgjedhjeve të mira, brenda një procesi përfshirës. Komisioni ka marrë një ndihmë të çmuar nga grupi i ekspertëve teknikë, si dhe nga misioni i ekspertëve teknikë të OSBE/ODIHR-it.

A vazhdoni të jeni optimist për realizimin e Reformës Zgjedhore në kohën e duhur apo mendoni se do të shtyhet sërish afati ?

Mandati i komisionit të posaçëm për reformën zgjedhore skadon këtë të martë dhe koha e planifikuar për të arritur në përfundim lidhur me çështje të rëndësishme zgjedhore mund të numërohet në minuta. Di që komisioni dhe ekspertët kanë punuar vërtet shumë, shpesh duke mos pasur parasysh orët e vona dhe ditët e pushimit. Do të doja ta përgëzoja përkushtimin e tyre në këtë shërbim publik dhe t’i ftoja më tutje të vijojnë me përkushtim maksimal, në mënyrë që reforma të përfundojë sa më shpejt. Do të thosha se kalimi paksa i afatit nuk përbën ndonjë problem të madh për hapin e madh që e pret Shqipërinë përpara, pasi të përfundojë reforma.

Ndërkombëtarët janë kritikuar për një qëndrim jo korrekt dhe jo konsekuent në raport me problemet e krizës shqiptare. Si e vlerësoni ju këtë si Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri?

Nuk pajtohem me këtë mendim. Komuniteti ndërkombëtar ka bërë thirrje dhe do të vazhdojë të bëjë thirrje për respektimin e institucioneve kushtetuese të Shqipërisë dhe për nivelin më të lartë të bashkëpunimit mes të gjithë aktorëve politikë. Ne, përfshirë edhe Prezencën e OSBE-së, i kemi ftuar partitë ta përdorin plotësisht Kuvendin, si forumin kryesor për debat politik. Është e rëndësishme të thuhet se kjo gjë ka ndodhur e po ndodh në vitin 2012. Komuniteti ndërkombëtar është i interesuar për demokracinë

funkionale, ne nuk na interesojnë ngjyrat e partive. Këto të fundit janë për votuesit, për të vendosur në zgjedhje. Për partnerët ndërkombëtarë të Shqipërisë, ajo që është më e rëndësishme është progresi i Shqipërisë në axhendën e reformave. Do të isha i lumtur të shihja shtetin e së drejtës të funksiononte më mirë, mirëqenie më të lartë në të tërë shoqërinë, më shumë vende pune, arsimim dhe kujdes shëndetësor më të mirë – shkurt, një mjedis më të mirë ku të jetojnë njerëzit. Që të arrijmë në atë pikë, vendit i duhen udhëheqës politikë të talentuar dhe të gatshëm për të negociuar për të arritur një konsensus – idealisht, bazuar në ide të shëndosha – bazuar në interesin kombëtar.

Zoti Ambasador, ju jeni shprehur se presidenti i ardhshëm i Republikës duhet të jetë një president konsensual. Sa mendoni se do të ndiqet ky sugjerim nga politika shqiptare?

Diskutimet e deritanishme dhe të pritshme rreth çështjes së Presidentit të Republikës së Shqipërisë janë sinjale inkurajuese. Vetëm përmes një përkushtimi të plotë mund të mbërrihet në një përfundim pozitiv. Presidenti është një institucion kushtetues. Ai ose ajo është simboli i bashkimit kombëtar. Partitë politike kanë mundësinë të tregojnë plotësisht se mund t'i lënë mënjane interesat partiake dhe të bien dakord për një kandidat që do ta kryejë detyrën e Kryetarit të Shtetit në mënyrën më dinjitoze, në interesin kombëtar. Tani po i afrohem fillimit të procesit për zgjedhjen e Presidentit. Ndërsa është koha që kandidatët të shqyrtohen dhe, më pas, të emërohen e të paraqiten, do të dëshiroja të theksoja që drejtimi dhe pronësia e këtij procesi duhet të mbetet në duart e partnerëve tanë shqiptarë. Bashkësia ndërkombëtare do të vazhdojë ta ndjekë këtë proces nga shumë afër. Do të thosha se, për t'iu përgjigjur ambicieve të saj kombëtare, Shqipëria duhet të zhvillojë një proces dinjitoz, i cili me shpresë do të çojë në një rezultat dinjitoz.

A është bërë progresi i kërkuar në Shqipëri në luftën kundër korrupsionit dhe vendosjen e raporteve të mirëbesimit dhe të respektimit të institucioneve në Shqipëri? Sipas jush, cilat janë akoma ato kushte, kërkesa që nuk janë arritur?

Toleranca ndaj korrupsionit duhet të jetë zero. Shqipërisë i nevojitet të punojë akoma për të arritur në një nivel ku ndershmëria mbizotëron ndaj mashtrimit. Roli aktiv i publikut është i një rëndësie parësore në dënimin e korrupsionit dhe në çuarjen e zyrtarëve të korruptuar përpara drejtësisë, pavarësisht pozicionit të tyre, duke futur këtu edhe gjyqtarët. Qytetarët duhet t'i shfrytëzojë plotësisht institucionet përkatëse kur bëhet fjalë për ngritjen e ankesave për shkeljen e të drejtave të tyre individuale. Zyra e Avokatit të Popullit është thelbësore në këtë kontekst. Unë do ta ftoja publikun ta përdorë plotësisht këtë zyrë. Gjithashtu, do të doja të shihja një nivel komunikimi më profesional e më të respektueshëm mes institucioneve shtetërore, në mënyrë që të ashtuquajturat tri pushtete të punojë në harmoni më të madhe me njëri-tjetrin në çuarjen e vendit përpara. Media, e quajtur shpesh pushteti i katërt, po ashtu, mund të kontribuojë jashtëzakonisht në luftimin e kancerit të korrupsionit.

Mendoni që konfliktualiteti politik në Shqipëri, ku sa më shumë afrojnë zgjedhjet ka të ngjarë që të rritet, do të rrezikojë konsensusin e palëve politike në plotësimin e të gjitha prioritetëve të BE-së ndaj Shqipërisë për marrjen e statusit të Kandidatit?

Konsensusi politik që nisi nëntorin e shkuar ka prodhuar deri tani disa rezultate shumë të rëndësishme dhe e ka afruar Shqipërinë me synimet e saj të përgjithshme kombëtare. Gjithsesi, ky konsensus duhet të vazhdojë më tej dhe të prodhojë rezultate shtesë, të cilat kërkohen, në mënyrë që Shqipëria të bëjë akoma më përpara. Çmimi po pret në fund të rrugës. Por, që të bëjnë përpara në atë rrugë, politikanët shqiptarët duhet të vazhdojnë të ecin. Ata nuk mund t'i lejojnë vetes të rrinë në vend, pasi Shqipëria nuk mund t'i lejojë vetes të rrijë në vend.

A mund të shërbejë modeli Gjerman i zgjedhjes së Presidentit si shembull edhe për Shqipërinë ?

Do të thosha këtë: Kushtetuta e Shqipërisë përcakton mënyrën se si zgjidhet Presidenti i Republikës. Gjermania, si shtet federal, ka 16 shtete rajonale. Duket qartë që ka një ndryshim të madh me Shqipërinë, duke filluar që nga madhësia. Nuk shoh ndonjë nevojë për të ndryshuar procedurat në këtë drejtim në Shqipëri. Siç thashë, udhëheqja dhe pronësia e këtij procesi u përket qartazi shqiptarëve. Gjërat më thelbësore që duhen mbajtur parasysh janë: respekti për Kushtetutën dhe interesat kombëtarë, që do të thonë qartë integrim evropian.

Moszgjedhja e një Presidenti konsensual, a mendoni se e vështirëson rrugën e Shqipërisë drejt integritit?

Procesi i zgjedhjes së Presidentit do të ndiqet nga afër nga komuniteti ndërkombëtar, përfshirë Prezencën e OSBE-së në Shqipëri. Jetike në këtë proces është që Kushtetuta e Shqipërisë të respektohet plotësisht, si në shkronjë, ashtu edhe në frymë. Po ashtu, është e rëndësishme që procedurat të zhvillohen në mënyrë dinjitoze.

Për kaç kohë sa keni qenë në krye të prezencës së OSBE në Tiranë, si e shihni klimën politike drejt përmirësimit apo përkeqësimit?

Vërej që klima politike është përmirësuar disi dhe kjo ka sjellë arritje pozitive në disa fusha. Zhvillimi më i rëndësishëm ishte, padyshim, kthimin i parlamentit në rolin e tij si skena kryesore për dialog politik. Kjo ka mundësuar miratimin e disa vendimeve legjislative shumë të rëndësishme, si për shembull zgjedhja e Avokatit të Popullit apo, së fundmi, miratimi i ligjit për gjykatat administrative. Do të shpresoja e do të prisja që kjo frymë vullneti të mirë të ruhet e të forcohet më tej, në mënyrë që të bihet dakord për reforma të tjera të shumënevojitura, sikurse është reforma zgjedhore. Duhet ta shohim Shqipërinë të bëjë disa hapa të vendosur më tutje. Nevojitet një klimë më e mirë. Sigurisht, krijimi i besimit kërkon kohë. Unë shpresoj, në të mirë të të gjithë qytetarëve shqiptarë dhe, gjithashtu, për të mirën e rajonit, që të shohim një besim më të madh politik në Shqipëri.

Shpeshherë ndërkombëtarët marrin rolin e moderatorit mes palëve politike. A është normale kjo për një vend demokratik? Edhe ju ditët e fundit përmendët një emër konkret për kandidat për anëtar të Gjykatës Kushtetuese për të cilën pati reagime. Si ta kuptojmë këtë?

E thënë shumë thjesht: synimi është të ndihmojmë partnerët tanë shqiptarë në gjetjen e rrugës përpara. Në kohët e sotme, asnjë vend, për më tepër, asnjë vend demokratik nuk funksionon në “vakum demokratik”. Shtetet ndërvetrojnë me njëri-tjetrin dhe mësojnë

nga përvojat e njëri-tjetrit, nga sukseset dhe dështimet e tyre. Disa demokraci janë krijuar shumë kohë më parë, prandaj, kanë një koleksion më të madh praktikash, nga të cilat demokracitë më të reja mund të mësojnë. Lidhur me çështjen e vendit bosh në Gjykatën Kushtetuese, kjo është një zgjedhje e vonuar në parlament. Gjendja e Gjykatës Kushtetuese, që funksionon vetëm me tetë anëtarët dhe me kërcënimin e përhershëm të barazimit të votave, është qartësisht e padëshirueshme, nga cilado anë që ta kapim. Disa muaj më parë, Presidenti i Republikës paraqiti propozimet e tij. Unë mora përgjigje shumë inkurajuese kur nxora në pah nevojën për të plotësuar vendin bosh. Tani është koha që Kuvendi të marrë një vendim.

ODIHR deklaroi se nuk do të pranojë numërimin elektronik të votave në zgjedhjet e 2013. Ju jeni i të njëjtit mendim? A mund të na thoni shkakun pse ODIHR është kundër numërimit elektronik pikërisht 3 ditë para përfundimit të afatit ?

Në fund të fundit, vendimi lidhur me këtë çështje u takon shqiptarëve. Gjithsesi, lejomëni ta shfrytëzoj këtë mundësi për të thënë disa fjalë rreth rolit të OSBE/ODIHR-it në reformën zgjedhore. Ata e kanë asistuar komisionin e posaçëm në bazë të një kërkesë zyrtare të Kuvendit, në fund të vitit të shkuar. Që atëherë, ata e kanë vizituar Tiranën së paku në pesë raste, si dhe kanë ofruar ekspertizë *online*. Rekomandimet e tyre bazohen në standardet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare, si dhe në praktikat më të mira. Gjithsesi, këto janë qartazi rekomandime, jo urdhëresa. Është në dorën e aktorëve shqiptarë të vendosin nëse do t'i pranojnë apo jo. Teknologjitë e reja të votimit mund ta përmirësojnë procesin zgjedhor dhe të japin rezultate më të shpejta. Megjithatë, vënia e tyre në përdorim ka nevojë për kohën e duhur që të arrihen këto rezultate pozitive. Kjo kohë duhet për të përgatitur plotësisht dispozitat ligjore, për të hartuar projektin, për të siguruar fondet, për të zhvilluar tenderin për pajisjet dhe për të trajnuar njerëzit që do t'i përdorin ato. Nëse shohim përvojat e vendeve të tjera, ato janë prirur të fillojnë me një projekt pilot në shkallë të vogël, për të identifikuar përparësitë dhe mangësitë e teknologjive të reja. Le të shohim se çfarë do të vendosë Komisioni lidhur me këtë çështje. Meqë jemi në këtë pikë, lejomëni të theksoj se edhe pajisjet më të përsosura elektronike nuk mund ta zëvendësojnë besimin midis aktorëve – dhe aktorët janë qenie njerëzore.

Fund